

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

MINISTRI

Nr. 1815 Prot.

Tiranë, më 23.02 2016

URDHËR

Nr. 84, datë 23.02 2016

PËR

SHPALLJEN E KONKURISIT TË TEKSTEVE SHKOLLORE TË REJA PËR KLASËN E DYTË DHE KLASËN E SHTATË, VITI SHKOLLOR 2016 - 2017

Në mbështetje të nenit 47 të Ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe të Vendimit nr. 107, datë 10.02.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit arsimor parauniversitar", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Shpalljen e konkursit për tekste shkollore të reja, për vitin shkollor 2016-2017, si më poshtë:
 - a) Për tekstet shkollore të klasës së dytë të arsimit fillor:
 - a.1 Gjuha shqipe 2;
 - a.2 Matematika 2;
 - a.3 Dituri natyre 2;
 - a.4 Edukim për shoqërinë 2.
 - b) Për tekstet e shkollore të klasës së shtatë të arsimit të mesëm të ulët:
 - b.1 Gjuha shqipe 7;
 - b.2 Matematika 7;
 - b.3 Fizika 7;
 - b.4 Biologjia 7;
 - b.5 Qytetaria 7;
 - b.6 Historia 7;
 - b.7 Gjeografia 7;
 - b.8 Muzika 7;
 - b.9 Arti pamor 7;

Adresa : Rruga e Durrësit
Nr. 23, AL-1001, Tiranë
Tel: +355 4 2222260, Fax : +355 4 2232002

Web site: www.arsimi.gov.al

- b.10 TIK 7;
- b.11 Gjuha angleze e parë 7;
- b.12 Gjuha angleze e dytë 7;
- b.13 Gjuha frënge e parë 7;
- b.14 Gjuha frënge e dytë 7;
- b.15 Gjuha italiane e parë 7;
- b.16 Gjuha italiane e dytë 7;
- b.17 Gjuha gjermane e parë 7;
- b.18 Gjuha gjermane e dytë 7.

2. Datat e aktiviteteve për konkursin e teksteve shkollore të reja janë:

- | | |
|--|----------------------------|
| a) Shpallja e konkursit | Shkurt 2016; |
| b) Dorëzimi i teksteve shkollore për vlerësim: | 25, 26 dhe 27 prill 2016; |
| c) Shpallja e fituesve: | 20 maj 2016; |
| d) Përzgjedhja e teksteve dhe porosia te botuesit: | 10-17 qershor 2016; |
| e) Shitja e teksteve: | 25 gusht –14 shtator 2016. |

3. Hartimi i teksteve shkollore bëhet në përputhje me programet e reja mësimore 2016-2017 dhe në respektim të standardeve të teksteve shkollore, të miratuara nga MAS-i.

- a) Nisur nga plotësimi i kriterëve mbi përshtatshmërinë e programeve tona me tekstet e huaja, tekstet shkollore: Matematikë 2, Dituri natyre 2, Matematikë 7, Fizikë 7 dhe Biologji 7, të jenë përkthim i teksteve shkollore të shtëpive botuese “Oxford University Press”, “Pearson” dhe Cambridge, dokumentuar me kontratë paraprake të lidhur mes subjekteve. Me lejen paraprake përkatëse nga botuesi i huaj, përkthimet mund të përshtaten në realitetin shqiptar për elementet që i përkasin realitetit të huaj. Formatu fizik i tekstit të paraqitur duhet të jetë i njëjtë me tekstin origjinal (tekst, fletore pune, në rastin kur origjinali i ka fizikisht të ndarë, si pjesë plotësuese e librit të nxënësit).
- b) Shtëpitë botuese, kanë të drejtë të konkurrojnë vetëm me një alternativë nga tekstet shkollore të shtëpive botuese “Oxford University Press”, “Pearson” dhe Cambridge, për lëndë/klasë, dhe të paraqesin tekstet origjinale përkatëse.
- c) Tekstet shkollore “Gjuhë e huaj e parë” (Anglisht 7, Frëngjisht 7, Italisht 7, Gjermanisht 7) dhe “Gjuhë e huaj e dytë” (Anglisht 7, Frëngjisht 7, Italisht 7, Gjermanisht 7) të paraqiten në versionin e tyre origjinal, botim i shtëpive botuese të huaja, përkatësisht, angleze, franceze, italiane dhe gjermane.
- d) Teksti shkollor, që paraqitet për konkurs, të përputhet me kriteret e përcaktuara në udhëzimin përkatës dhe standardet e teksteve shkollore.
- e) Shtëpitë botuese që do të konkurrojnë për tekstin e lëndës “Edukim për shoqërinë”(klasa e dytë) dhe për tekstin e lëndës “Qytetaria” (klasa e shtatë), nuk do të përgatitin kreun me tematikë: “Prodhimi, shpërndarja dhe konsumi”. Autor për këtë tematikë do të jetë Junior Achievement si më poshtë.:
 - e.1 Klasa e 2-të
 - Lënda: Edukim për shoqërinë
 - Tematika 3: Prodhimi, shpërndarja dhe konsumi
 - Tema: Familjet tona(7 orë)

e.2 Klasa e 7-të
Lënda: Qytetari
Tematika 3: Prodhimi, shpërndarja dhe konsumi
Tema: Tregu global (8 orë)

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij Urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit Parauniversitar dhe Komisioni i Vlerësimit të Teksteve Shkollore në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR

